


30 DITË në AMA

DËRGO ANKESË PËR RADIO DHE TELEVISIONE



**Transparencë AMA-
Platforma X,
identifikohen 22
përmbajtje në shkelje
të ligjit**



**Krasniqi në tryezën e konsultimit
mbi draftin e Kodit të ri Penal: Do të
donim më shumë mbrojtje të posaçme
për gazetarët**

DËRGO ANKESË PËR PLATFORMËN X




**Konventa Kombëtare për
Integrimin European: Sfida e
AMA-s, krijimi i një tregu
audioviziv i standardeve
europiane**

Kryetarja e Autoritetit të Mediave Audiovizive mori pjesë në sesionin plenar të Konventës Kombëtare për ...

**Nënshkruhet
Marrëveshje
Mirëkuptimi mes
AMA-s dhe Kolegjit
Universitar të Biznesit**

Kryetarja e Autoritetit të Mediave Audiovizive, Znj. Armela Krasniqi dhe Rektori i Kolegjit Universitar...



**Tryeza: Liria e shprehjes
dhe e medias në Shqipëri
bën bashkë shoqëri civile,
institucione dhe gazetarë.
Hapat e hedhur nga AMA,
nga transparenca e
pronësisë tek përshtatjet
ligjore**

SCIDEV dhe Faktoje.al, organizuan tryezën me temë "Liria e Shprehjes..."

Krasniqi në tryezën e konsultimit mbi draftin e Kodit të ri Penal: Do të donim më shumë mbrojtje të posaçme për gazetarët

Kryetarja e Autoritetit të Mediave Audiovizive, Znj. Armela Krasniqi ishte pjesë e tryezës konsultative mbi draftin e Kodit të ri Penal, organizuar nga Ministria e Drejtësisë. Ajo dha disa sugjerime konkrete mbi draftin e Kodit Penal, specifikisht në nenet 235, 267, 536, 863 dhe 865, ndërsa shtoi se do të donte që draft Kodi i ri Penal të ofronte më shumë mbrojtje të posaçme për gazetarët, punonjësit e medias ose sinjalizuesit.

[Lexo më shumë](#)



Transparenca AMA-Platforma X, identifikohen 22 përmbajtje në shkelje të ligjit

41 përmbajtje janë administruar nga ekipi i shqyrtimit të ankesave të publikut për përmbajtje të dëmshme të publikuara në Platformën X. Nga këto, 22 përmbajtje janë identifikuar në shkelje të ligjit dhe janë raportuar në kanalin e dedikuar për AMA-n në këtë platformë. Ankesat më të shumta kanë të bëjnë me tejkalim të standardeve morale dhe etike, nxitje dhune dhe urrejtje si dhe ekspozim të fëmijëve ndaj pornografisë, narkotikëve, alkoolit dhe duhanit.

[Lexo më shumë](#)



Konventa Kombëtare për Integrimin European: Sfidë e AMA-s, krijimi i një tregu audioviziv i standardeve europiane

Kryetarja e Autoritetit të Mediave Audiovizive mori pjesë në sesionin plenar të Konventës Kombëtare për Integrimin European, zhvilluar në Tiranë. Krasniqi u tha të pranishmëve se AMA funksion si ent plotësisht i pavarur dhe këtë e dëshmojnë vendimet e arritura me konsensus dhe asnjëherë të kontestuara.

[Lexo më shumë](#)

Nënshkruhet Marrëveshje Mirëkuptimi mes AMA-s dhe Kolegjit Universitar të Biznesit



Kryetarja e Autoritetit të Mediave Audiovizive, Znj. Armela Krasniqi dhe Rectori i Kolegjit Universitar të Biznesit, Prof. Dr. Ylber Bezo nënshkruajnë Marrëveshjen e Mirëkuptimit mes dy institucioneve. "Kemi rënë dakord për organizimin e aktiviteteve të përbashkëta, si dhe shkëmbim ekspertizash shkencore apo prezantime të kërkimit shkencor të stafit akademik në AMA, çdo herë që të jetë e mundur", – tha kryetarja e AMA-s.

[Lexo më shumë](#)



Tryeza: Liria e shprehjes dhe e medias në Shqipëri bën bashkë shoqëri civile, institucione dhe gazetarë. Hapat e hedhur nga AMA, nga transparenca e pronësisë tek përshtatjet ligjore

SCiDEV dhe Faktoje.al, organizuan tryezën me temë "Liria e Shprehjes dhe Liria e Medias në Shqipëri: Midis përparimit dhe ngeçjes – Reflektime mbi Raportin e BE-së 2025 dhe rruga drejt llogaridhënies", ku u diskutuan sfidat dhe arritjet e vendit në këtë fushë, si dhe prioritetet për vitin 2026. E pranishme në këtë tryezë, kryetarja e AMA-s Armela Krasniqi theksoi se, Liria e Shprehjes dhe e Drejtës për Informim janë dy shtylla kryesore të punës së institucionit që ajo drejton.

[Lexo më shumë](#)